

Në Samitin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim të Qëndrueshëm, më 25 shtator 2015, udhëheqësit e botës aprovuan Axhendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, që përfshin 17 Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs) për t'i dhënë fund varfërisë, për të luftuar pabarazitë e padrejtësitë dhe për të adresuar ndryshimet klimaterike deri në vitin 2030. Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, ndryshe njohur si Objektivat Globalë, janë vijimësi e Objektivave për Zhvillim të Mijëvjeçarit (MDGs), tetë synime anti-varfëri që bota u angazhua t'i arrinte deri në vitin 2015. SDGs e reja dhe axhenda më e gjerë për zhvillim të qëndrueshëm shkojnë më tej se MDGs, sepse adresojnë shkaqet e varfërisë dhe nevojat universale për zhvillim, me përfitim për të gjithë njerëzit.

1 PA
VARFËRI



Objektivi 1. Eliminimi i varfërisë në të gjitha format, kudo.

2 ZERO
URI



Objektivi 2. Eliminimi i urisë, arritja e sigurisë ushqimore dhe përmirësimit të ushqyerjes dhe nxitja e bujqësisë së qëndrueshme.

3 SHËNDET I MIRË
DHE MIRËQENIE



Objektivi 3. Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe nxitja e mirëqenies për të gjithë njerëzit e çdo moshe.

4 ARSIM
CILËSOR



Objektivi 4. Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të drejtë dhe nxitja e mundësive për mësim gjatë gjithë jetës për të gjithë.

5 BARAZI
GJINORE



Objektivi 5. Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave.

6 UJË I PASTËR
DHE KANALIZIME



Objektivi 6. Sigurimi i disponueshmërisë dhe administrimit të qëndrueshëm të ujës jellës-kanalizimeve për të gjithë.

7 ENERGJI E
PËRBALLUESHME
DHE E PASTËR



Objektivi 7. Sigurimi i lidhjes me energji të përballueshme, të sigurt, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë.



Objektivi 8. Nxitja e rritjes ekonomike të vazhdueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësim i plotë dhe produktiv dhe punë e denjë për të gjithë.



Objektivi 9. Ndërtimi i infrastrukturave rezistuese, nxitja e industrializimit gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm dhe nxitja e novacionit.



Objektivi 10. Zvogëlimi i pabarazive brenda për brenda vendeve dhe midis tyre.



Objektivi 11. Kthimi i qyteteve dhe vendbanimeve në gjithëpërfshirës, të parrezikshëm, rezistues dhe të qëndrueshëm.



Objektivi 12. Sigurimi i modeleve të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit.



Objektivi 13. Marrja e masave për të luftuar ndryshimin klimatik dhe efektin e tij (në bazë të marrëveshjeve të arritura në forumin e Konventës kuadër të OKB-së për Ndryshimin e Klimës, UNFCCC).



Objektivi 14. Ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i oqeanëve, deteve dhe burimeve detare për zhvillimin e qëndrueshëm.



Objektivi 15. Mbrojtja, restaurimi dhe nxitja e përdorimit të qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore, administrimi i qëndrueshëm i pyjeve, lufta kundër kthimit të hapësirave në shkretëtirë dhe ndalimi dhe kthimi pas i procesit të degradimit të tokës.



Objektivi 16. Nxitja e shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimi i mundësisë për drejtësi për të gjithë dhe ngritja e institucioneve të efektshme, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet.



Objektivi 17. Fuqizimi i mënyrave të vënies në zbatim dhe rigjallërimi i partneritetit botëror për zhvillim të qëndrueshëm.